

VENDIM
Nr. 319, datë 12.12.2025

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “SUNPRO” SHPK PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1648/22 prot., datë 10.12.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘SunPro’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 98, datë 12.5.2025, vendosi të filloj procedurën për licencimin e shoqërisë “SunPro” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali eolik, me kapacitet prodhues 3 mw, me vendndodhje në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë.

- Në vijim të korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë në lidhje me informacionin/ dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi dhe në rrethanat që shoqëria nuk ishte pajisur ende me miratimin përfundimtar, pra marrëveshjen e nënshkruar me “OST” sh.a., për pikën e lidhjes së centralit eolik me rrjetin e transmetimit.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 148, datë 8.7.2025, pezulloi afatin e vendimmarrjes për licencimin e shoqërisë “SunPro” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, duke i lënë kohë shoqërisë për depozitimin e dokumentacionit të munguar deri në datën 30.9.2025. Ky vendim i është njoftuar shoqërisë nëpërmjet shkresës nr. 1648/16 prot., datë 15.7.2025.

- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1648/17 prot., datë 28.8.2025, shoqëria bëri me dije se ka bërë kërkesën pranë “OST” sh.a. për ofertë lidhje të parkut eolik me kapacitet 3 mw me rrjetin e transmetimit, të cilën po ashtu e ka depozituar bashkëlidhur.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 212, datë 9.9.2025, vendosi të ndryshojë vendimin nr. 148/2025, duke lënë në fuqi pezullimin dhe duke shtyrë afatin për depozitimin e dokumentacionit të munguar deri në datën 22.11.2025. Ky vendim i është njoftuar shoqërisë nëpërmjet shkresës nr. 1648/19 prot., datë 10.9.2025.

- Me shkresën e saj të datës 20.11.2025, protokolluar në ERE me nr. 1648/21 prot., datë 25.11.2025, shoqëria ka bërë me dije se ende nuk ka marrë një përgjigje nga “OST” sh.a., në lidhje me kërkesën e saj për lidhje me rrjetin, për të cilën i është drejtuar edhe me shkresën e datës 19.11.2025, me lëndë “Rikujtesë për kërkesën për ofertë lidhje me rrjetin e transmetimit”, të cilën e ka depozituar dhe në ERE.

- Për gjithë sa më sipër, rezulton se shoqëria ka kthyer përgjigje brenda afatit të përcaktuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 148/2025, i ndryshuar me vendimin nr. 212/2025, si e tillë vlerësohet se duhet të vijohet me heqjen e pezullimit për këtë procedurë.

- Nga analizimi i këtij aplikimi, rezulton se nevojitet të zhvillohet një korrespondencë me “OST” sh.a., për t’i kërkuar asaj informacionin përkatës në lidhje me fazën ku ndodhet kërkesa e shoqërisë për ofertën për lidhjen me rrjetin e transmetimit.

- Po ashtu, në lidhje me sa përcaktuar në dokumentet e aplikimit dhe për sa parashikuar nga vetë shoqëria, për të vendosur në operim centralin brenda datës 13.3.2026, vlerësohet t'i kërkohej informacion/argumentim shoqërisë në rast se ky afat do të arrihet nga ana e saj ose t'i kërkohej raportimet përkatëse të depozituara në MIE, në lidhje me ecurinë e projektit dhe/ose nevojën e mundshme për shtyrjen e këtij afati.

Heqja e pezullimit dhe zgjatja e afatit të vendimmarrjes

- Në nenin 14, pika 3, të rregullores parashikohet se Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.

- Për gjithë sa më sipër, vlerësohet që të vijohet me heqjen e pezullimit, të vendosur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 148/2025, i ndryshuar me vendimin nr. 212/2025 dhe të zgjatet me 30 ditë vendimmarrja e Bordit, në lidhje me aplikimin e shoqërisë, me qëllim zhvillimin e korrespondencës përkatëse me "OST" sh.a., në lidhje me pikën e lidhjes së centralit eolik me rrjetin e transmetimit dhe me vetë shoqërinë në lidhje me afatet e vënies në punë të centralit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të heqë pezullimin e vendosur me vendimin e Bordit nr. 148, datë 8.7.2025, "Mbi pezullimin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë 'SunPro' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike", i ndryshuar.

2. Të zgjasë me 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë "SunPro" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali eolik, me kapacitet prodhues 3 mw, me vendndodhje në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "SunPro" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti